

## **Thirrje Publike për Pikë Rajonale që në të ardhmen do të mbështesin zhvillimin e ndërmarrjeve sociale**

### **Thirrje për Aplikime**

Thirrje për pjesëmarrje në aktivitetet e projektit për themelimin të **2 pikëve rajonale** për mbështetje të ndërmarrjeve sociale në **Ohër** dhe **Veles**

Projekti i financuar nga BE-ja **"Mbështetje për Ndërmarrjet Sociale "** që zbatohet nga Konzorciumi Eptisa / Barka / Ecorys në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale gjatë periudhës Gusht 2020 – Gusht 2022 do të mbështesë punësimin e qëndrueshëm afatgjatë dhe mundësitë për biznes për grupet e cënueshme dhe të marginalizuara duke krijuar struktura për mbështetje të ndërmarrjeve sociale. Aktivitetet që do të implementohen përfshijnë: hartimi i kornizës koherente ligjore, rregullatore, për mbështetje financiare dhe monitorim për ndërmarrjet sociale, ndërtimi i kapaciteteve (edukim dhe trajnim, stërvitje për biznes); themelim, organizim, menaxhim dhe operim me strukturë mbështetëse për ndërmarrjet lokale me pikë lokale kontakti dhe mbështetje për krijim të ekosistemit për zhvillim të sipërmarrësisë sociale.

**Kjo është thirrje për subjektet lokale që janë të interesuara për të mbështetur ekonomitë lokale përmes qasjeve inovative të sipërmarrësisë sociale duke promovuar parimet e solidaritetit dhe fuqizimit të grupeve të marginalizuara, duke krijuar bashkëveprim brenda për brenda partneriteteve lokale dhe ndërtimit të modeleve të qëndrueshme të biznesit.**

**Subjektet duhet të jenë të gatshëm të ofrojnë mbështetje teknike dhe të ndonjë lloji tjetër për ndërtim të kapaciteteve të palëve të ndryshme relevante lokale në përpjekjet e tyre për të themeluar ose zgjeruar ndonjë ndërmarrje sociale (ju lutemi lexoni me kujdes kriteret e bashkëlidhura për tu përzgjedhur).**

Subjektet lokale/ aplikantët e zgjedhur do të mbështeten me trajnime të organizuara posaçërisht për ndërtim të kapaciteteve, informim, këshillim, qeverisje etj. dhe me qasje individuale.

Komisioni për përzgjedhje sipas kriterëve për përzgjedhje do të vlerësojë formularët e identifikimit të dorëzuar brenda afatit. Aplikantët do të vlerësohen brenda 10 ditëve nga afati i dorëzimit. Sipas kriterëve të vlerësimit, një aplikant për rajon (8 gjithsej) do të zgjidhet si i kualifikuar për pikë lokale për të mbështetur ndërmarrjet sociale në kuadër të projektit. Kandidatëve të zgjedhur do u dërgohet letër e posaçme që do i informojë mbi hapat e ardhshëm.

Për sa i përket fuqizimit të Pikëve Rajonale që do të mbështesin sipërmarrësinë sociale, duhet theksuar që ky projekt do të caktojë 1-person nga stafi që do të sigurojë informata, do të bëjë organizimin e takimeve, trajnimeve, seancave për trajnim dedikuar ndërmarrjeve sociale ekzistuese ose atyre të sapokrijuarave. **Pika e Kontaktit për Mbështetje lokale do të mbështetet financiarisht (max. 13 600 EUR) gjatë një periudhe 17 mujore për të mbuluar rrogën dhe shpenzimet e tjera për të siguruar shërbimet e nevojshme sipas raporteve mujore deri në 1 shtator, 2022.**

**Afati për dorëzim të Formularit për Identifikim në formë elektronike nga aplikantët e interesuar është 12.00, 19 prill, 2021 – formulari duhet dorëzuar në këtë adresë elektronike në gjuhë angleze: [supsocent@eptisa.com](mailto:supsocent@eptisa.com)**